



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2253, datë 23.01.2013

Për
Miratimin e Dokumentit rregullator “Për disa ndryshime dhe shtesa në Rregulloren
Nr.21, datë 18.03.2011 “Për Licencën e Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve
Postare”

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

1. Z.	Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z.	Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj.	Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z.	Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj.	Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 23.01.2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e Dokumentit rregullator “Për disa ndryshime dhe shtesa në Rregullore Nr.21, datë 18.03.2011 “Për Licencën e Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare””

BAZA LIGJORE:

1. Pika 1 e nenit 114 dhe neni 115 te ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr.9918**);
2. Neni 7/1 i ligjit Nr.8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin Nr.10132, date 11.05 2009 (**Ligji 8530**).
3. Neni 120 dhe neni 129 i ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**KPrA**), i ndryshuar;
4. Pika 1 e nenit 7 të Rregullores Nr.21, datë 18.03.2011 “Për Licencën e Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare” (**Rregullore Nr. 21**), miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP-it, Nr. 1532, datë 18.03.2011.

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- Projekt Vendimi;
- Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;
- Projekt-Dokumenti rregullator “Për disa ndryshime dhe shtesa në Rregullore Nr.21, datë 18.03.2011 “Për Licencën e Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare””,

si dhe, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke i’u referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP, me qëllim përmbushjen sa më të plotë dhe eficiente të detyrimeve ligjore që duhet të zbatojnë subjektet e interesuara, për t’u pajisur me “Licencën e Përgjithshme “Për Ofrimin e Shërbimeve Postare””, çmon si të rëndësishme ndryshimet dhe shtesat në aktin Rregullore Nr.21, datë 18.03.2011 “Për Licencën e Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare”, me qëllim përcaktimin e rregullave procedurale për t’u pajisur me licencë nëpërmjet modulit të aplikimeve online;
2. Grupi i punës i caktuar me Urdhërin nr. 900 datë 30.10.2012 ka hartuar ndryshimet dhe shtesat në projekt aktin administrativ Rregulloren Nr.21, datë 18.03.2011 “Për Licencën e Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare”, me qëllim përcaktimin e rregullave procedurale për kryerjen nëpërmjet modulit të aplikimeve online nga subjektet e interesuara për t’u pajisur nga AKEP me licencë;
3. Ndryshimet dhe shtesat për përcaktimin e rregullave procedurale në Rregulloren Nr.21, datë 18.03.2011 “Për Licencën e Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare”, janë mbështetur në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi si dhe rekomandimeve të UPU-së, duke patur parasysh dhe implementuar objektivat rregullatore të AKEP;
4. Ndryshimet dhe shtesat e propozuara në Rregulloren Nr.21 nga Grupi i Punës, për t’u zbatuar nga subjektet e interesuara për licencë, nëpërmjet modulit të aplikimeve online, bëhen pa ndryshuar përmbajtjen, objektin, qëllimin dhe kërkesat e përfshira në këtë rregullore si dhe me qëllim përmirësimi për:
 - Kalimin e aplikimit për “Licencën e Përgjithshme “Për Ofrimin e Shërbimeve Postare”” nëpërmjet modulit të aplikimeve online;
 - Realizimin e procedurës së paisjes me licencë në një kohë sa më të shkurtër, në një mënyrë më të thjeshtuar me rregulla praktike;
 - Shkurtimin e procedurave të përpunimit të dokumentacionit në AKEP duke rritur cilësinë e shërbimit ndaj subjekteve;
 - Realizimin e një procesi transparent në kufijtë e veprimit të Autoritetit Publik;
5. Për këtë qëllim, AKEP në zbatim të Ligjit nr. 9918, i ndryshuar, në kuadër të transparencës dhe paanësisë çmon si të arsyeshme miratimin e ndryshimeve dhe shtesave në përcaktimin e rregullave procedurale për kryerjen nëpërmjet modulit të aplikimeve online nga subjektet e interesuara për licencë, të projekt aktit administrativ Rregulloren Nr.21, datë 18.03.2011 “Për Licencën e Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare”;

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Këshilli Drejtues, duke konsideruar rëndësinë e miratimit të këtij projekt akti administrativ, për subjektet e interesuara për pajisjen me “Licencën e Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare”, bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918 i ndryshuar, neni 7/1 i ligjit Nr.8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Të miratojë Dokumentin rregullator “Për disa ndryshime dhe shtesa në Rregulloren Nr.21, datë 18.03.2011 “Për Licencën e Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare” sipas Aneksit 1 bashkëlidhur;
2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë nga data e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURÇE**

ANEKS 1

I. Ndryshime dhe shtesa në Rregulloren Nr.21, datë 18.03.2011 “Për dhënien e Licencës së Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare”.

(Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr.1532, datë 18.03.2011)

A. Shtohet pika 4 dhe pikat 1, 2, 3 të nenit 3, ndryshojnë dhe bëhen:

Neni 3 Procedura

1. Për t'u pajisur me “Licensë të Përgjithëshme”, cilido person fizik apo juridik, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.8530, përcaktimet në këtë rregullore, do të plotësojë dhe dërgoje Online Formularin e Aplikimit në faqen web: www.akep.al.
2. Dokumentacioni mbështetës që shoqëron aplikimin online për ofrimin e shërbimeve postare do të jetë si më poshtë:
 - a) Një deklaratë se personi ka kapacitete profesionale. Kapacitetet profesionale konsistojnë në pasjen e njohurive për sigurimin e një niveli të përshtatshëm të nivelit të cilësisë për ofrimin e shërbimeve postare.
 - b) Listën e cmimeve që do aplikojë për ofrimin e shërbimeve postare.
3. AKEP do të shqyrtojë aplikimin e dërguar online dhe do të vendosë të japë “Licencën e Përgjithëshme” brenda 7 (shtatë) ditëve nga plotësimi i formularit dhe dokumentacionit të kërkuar (i plotësuar sipas kërkesave të rregullores Ankesi 1). Nëse formulari ose dokumentacioni paraqitet jo i plotë atëherë brenda 5 (pesë) ditëve, ai do të rikthehet për t'u riplotësuar online. Licenca lëshohet e nënshkruar nga Kryetari.
4. Formulari i aplikimit online nënshkruhet nga subjekti në momentin e tërheqjes së Licencës dhe i bashkëngjitet praktikës që arkivohet në AKEP së bashku me dokumentacionin shoqërues.

B. Pika 2 e nenit 5, ndryshon dhe bëhet:

Neni 5 Vlefshmëria e Licencës së Përgjithshme

2. Aplikimet për rinovimin e “Licencës së Përgjithshme” do të bëhen online, jo më pak se 30 ditë dhe jo më shumë se 90 ditë përpara përfundimit të vlefshmërisë së tij, bazuar në legjislacionin në fuqi të periudhës.

C. Pika 1 e nenit 6, ndryshon dhe bëhet:

Neni 6
Transferimi i Licencës së Përgjithshme

1. Transferimi i “Licencës së Përgjithshme” për ofrimin e shërbimeve postare, bëhet vetëm me miratim nga AKEP, pas kërkesës online nga mbajtësi i Licencës, dhe vetëm nëse personi fizik ose juridik, të cilit kërkohet t’i kalohet kjo “Licencë e Përgjithshme” përmbush kërkesat e ligjit nr. 8530 dhe rregullat përkatëse, të zbatueshme nga AKEP-i.

D. Pika 1 e nenit 8, ndryshon dhe bëhet:

Neni 8
Revokimi i Licencës së Përgjithshme

1. AKEP-i revokon “Licencën e Përgjithshme” me kërkesën online të ofruesit të shërbimeve postare.

E. Paragrafi i parë i neni 10, ndryshon dhe bëhet:

Neni 10
Raportimi për shërbimet postare të ofruara

Ofruesit e shërbimeve postare do të raportojnë peridikisht online në AKEP në periudha 6-mujore (deri më 30 Shtator të vitit në vazhdim dhe deri më 31 Mars të vitit pasardhës);